



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.1031/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mehmet Ndrecaj kryetar, Delushe Halimi dhe Ramiz Kuqi, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqësojnë, Iliriana Sadiku dhe Naser Sadiku, zyrtarë të paditësit, kundër të paditurës Komuna e Pejës, për shkak të anulimit të vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2409/2018, të datës 08.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.01.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështjet Administrative, A.nr.2409/2018, i datës 08.10.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar A.nr.2409/2018, të datës 08.10.2021, e ka hedhur poshtë si të pasafatshme padinë e paditësit Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, të evidentuar me shenjë A.nr.2409/2018, të datës 08.10.2018.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur paditësi Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të anulohet, dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, ose i njëjti të ndryshohet, dhe të aprovohet në tërësi padia e paditësit.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore në ankesë lidhur me aktvendimin e atakuar, si dhe vlerësimit komplet shkresave të lëndës, në

mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është **e pa-bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ka paraqitur padi me datën 08.10.2018, kundër të paditurës Komuna e Pejës, për shkak të anulimit të vendimit me numër ... të datës 29.06.2018. Ndërsa me datën 28.09.2021, ka paraqitur parashtrësë për precizim të padisë, duke kërkuar që të anulohet aktvendimi nr. ... i datës 03.05.1995, i Kuvendit Komunal në Pejë – Sektori për Urbanizëm dhe për Punë Komunale Ndërtimore dhe Marrëdhënie Pronësore Juridike, si dhe Kontrata për dhënie në shfrytëzim nr. ... e datës 04.04.1995, e nxjerrë nga Fondi Shoqëror për Qeverisjen me Tokë Ndërtimore dhe i Rrugëve në Komunën e Pejës, pa kurrfarë baze të juridike të kthehet në emër të paditurës. Po ashtu, ka kërkuar që obligohet Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi në Pejë, që ti bëjë ndryshimet kadastrale sipas aktgjykimit, dhe prona të kthehet në emër të paditëses NSH [“K...”] në Pejë, si dhe të obligohet e paditura që ti bartë shpenzimet procedurale.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështjet Administrative, duke ju referuar dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vlerësuar se padia e paditësit është e pasafatshme për faktin se paditësi i ka lëshuar të gjitha afatet ligjore për ta kontestuar aktvendimin e të paditurës me nr. ... të datës 03.05.1995, të Kuvendit Komunal të Pejës – Sektori për Urbanizëm dhe Punë Komunale, Ndërtimore dhe Marrëdhënie Pronësore Juridike, duke kërkuar që i njëjti vendim të anulohet pas njëzet e gjashtë viteve.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 të LPK - së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas dispozitës së nenit 9 Ligjit për Konfliktet Administrative është përcaktuar se *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative”*.

Me dispozitën e nenit 13 par. 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative është përcaktuar se: *“1. Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë”*. Ndërsa në paragrafin 2 të të njëjtit nen është përcaktuar se: *“Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar”*. Kurse me nenin 14 të të njëjtit Ligj, përcaktohet se *“Konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj”*.

Në nenin 27 të Ligjit për Konfliktet Administrative është paraparë se: *“1. Padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës. 2. Ky afat aplikohet edhe për organin e autorizuar për paraqitjen e padisë, nëse i është dorëzuar akti*

administrativ. Nëse akti administrativ nuk i është dorëzuar, mund të paraqesë padinë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e dorëzimit të aktit administrativ palës, në favor të së cilës është nxjerrë akti.”. Kurse me nenin 34 par.1 pika 1.1 të LKA-së, është përcaktuar se “1. Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se: 1.1. padia është paraqitur pas kalimit të afatit ose është e parakohshme”.

Në rastin konkret Gjykata e Apelit e pranon përfundimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak se gjykata e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme përfundimin e saj për hedhjen poshtë si të pasafatshme të padisë së paditësit. Andaj, gjykata ankimore ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paraqitura me ankesë, për shkak se siç u theksua më lartë në rastin konkret paditësi i ka lëshuar të gjitha afatet ligjore për të kontestuar aktvendimin e lartcekur të paditurës.

Përfundimisht, Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë, për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim apo të vendoset ndryshe.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 209 par. 1 pika (b) e LPK-së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.1031/21, datë 25.01.2022

Kryetari i kolegjit- Gjyqtari,
Mehmet Ndrecaj